



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS NOVOBËRD

Numri i lëndës: 2023:014297

Datë: 11.03.2024

Numri i dokumentit: 05436017

P.nr.03/2023

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore në Gjilan - Dega në Novobërdë, gjyqtari Sadri Krasniqi, me zyrtaren ligjore Donjeta Zenuni, në lëndën penale kundër të pandehurit, P. A. M. nga fshati Tullar, Komuna e Novobërdës, për shkak të veprave penale; në vazhdim vjedhja e pyllit nga neni 349, parag.1, lidhur me nenin 77 të KPRK-së, sipas aktakuzave të PTH-së nga Gjilani, edhe ate: PP.II.nr.17/2023 e dt. 06.01.2023, PP.II.nr.22/2023 e dt.10.01.2023 dhe PP.II.nr.23/2023 e dt.10.01.2023, më datë 26.02.2024, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit gjyqësor, në prani të Prokurores së Shtetit Rozelida Manastiri, të pandehurit P. M., shpalli dhe publikisht komunikoi, ndërsa më datën 11.03.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I p a n d e h u r i :

P.M., pa pseudonim dhe emër të rrejshëm, nga i ati A. dhe ëma Q., e lindur M., i lindur më datë 25.06.1994, në fshatin Tullarë, K. e Novobërdës, ku edhe tani jeton, me nr. personal 1230145039, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i pamartuar, i pa punësuar, ka të kryer shkollën fillore, i gjendjes jo të mirë ekonomike, i dënuar edhe më parë për vepër tjetër penale, nuk udhëhiqet procedurë për vepër tjetër penale.

Ë s h t ë f a j t o r

Sepse:

I.

Më datën 24.06.2022, rreth orës 18:30 minuta, në territorin e fshatit Carevce, Komuna e Novobërdës, në pyllin e pronës shtetërore, tek vendi i quajtur "Quka", i pandehuri, me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm pasuror për veti, me dashje, me sharrë motorike, ka prerë 21

copë trungje të njoma, të lloit bung , me diametër në cung 15-20 cm, në lartësi të drurit 16 cm, me gjatësi 7-8 m, si dhe me vëllim të përgjithshëm prej 2.27 m³, , në këtë mënyrë të dëmtuarës APK-së, zyra në Novobërd, i ka shkaktuar dëmë material në vlerë të pa përcaktuar.

II.

Më datë 15.08.2022, rreth orës 16:20 minuta, në territorin e fshatit Carevce, Komuna e Novobërdës, në pyllin e pronës Shtetërore në vendin e quajtur “Quka”, i pandehuri, i pandehuri P.M., me qëllim vjedhje, me sharrë motorike ka prerë 47 copa drunjë të llojit bung, me diametër në cung 16-20 me lartesi tw drurit 17 cm, me gjatësi 9-10 m, me vëllim të përgjithshëm 4.65 m³, në këtë mënyrë të dëmtuarës AKP në Novobërd i ka shkaktuar dëm material në vlerë të pa përcaktuar.

III.

Më datë 21.08.2022 rreth orës 16.30h, në territorin e fshatit Carevc,K.Novobërdë, në vendin e quajtur “Quka”, ka vjedhë drunj në pyllin në pronësi shtetërore, e administruar nga Autoriteti Pyjor Komunal në Novobërdë, ,në atë mënyrë që me dashje dhe me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm për vete, i njëjti, ka prerë me sharrë motorike 58 copa trungje të njoma të llojit lis,me diametër në cung 14-20cm, me vëllim të përgjithshëm 4.70m³ , të cilat i ka bartuar me traktor të markës “Rakovica” , dhe në këtë mënyrë Autoritetit Pyjor Komunal në Novobërdë, i ka shkaktuar dëm material në vlerë të pa përcaktuar

- me çka ka veprën penale: *në vazhdim* vjedhja e pyejeve nga neni 349 parag. 1, lidhur me nenin 77 të KPRK-së.

Gjykata në bazë të nenit të lartë cekur dhe neneve 4, 38, 43, 69, 70 dhe 77 të KPRK-së, lidhur me nenet 242, 364, 453 të KPPRK-së, të pandehurin P.M. e,

G J Y K O N

Me dënim gjobe (në të holla) në shumë prej **200 €**, të cilën shumë ka për ta arkëtuar në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi **në këste mujore**, në të kundërtën i njëjti dënim me gjobë do t'i zëvendësohet me dënim burgu ashtu që për çdo 20 €, do t'i llogaritet nga një ditë burgu,

Pala e dëmtuar Agjencioni pujor, në K. Novobërdës, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

Detyrohet i pandehuri P. M., që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 €, krejt këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi me kanosje përmbarimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjilan, me aktakuzat, PP.II.nr.17/2023 e dt. 06.01.2023, PP.II.nr.22/2023 e dt.10.01.2023 dhe PP.II.nr.23/2023 e dt.10.01.2023, ka kërkuar që ndaj të pandehurit P. M. nga fsh.Tullarë, Komuna e Novobërdës, të fillohet dhe shtjellohet procedura penale, për shkak të veprave penale, vjedhja e pyllit nga neni 349, parag.1 të KPRK-së, të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit. Ndaj të cilit ka paraqitur edhe Kërkesat për dhënien e Urdhrit ndëshkimor dhe ka kërkuar që të pandehurit të i shqiptohet dënime me gjobë, pa e mbajtur shqyrtimin gjyqësor ngase janë plotësuar kushtet ligjore sipas nenit 493 parag. 2, lidhur me parag.1 të KPPRK-së.

Gjykata shqyrtoi dhe analizoi aktakuzat, Kërkesat për dhënien e urdhrit ndëshkimor dhe gjitha shkresat e tjera të lëndëve dhe konstatoi se duhet të pranohen kërkesat e PTH-së, për dhënien e urdhrit ndëshkimor ndaj të pandehurit dhe me Aktgjykimet me P.nr.3/23, P.nr.4/23 dhe P.nr.6/2023, të datës 17.07.2023 të akuzuarin e ka shpallur fajtor dhe i ka shqiptuar dënimet me gjobë në shumën prej nga 120 € për secilën lëndë.

I akuzuari i pa kënaqur me Aktgjykimet e cekura si më lartë, në afatin ligjor ka paraqitur kundërshtim, andaj gjykata konform dispozitave ligjore të nenit 496 paragrafi 4 të KPPRK-së, lidhur me këtë çështje penale për datë 26.02.2024, ka mbajtur seancën për shqyrtim gjyqësor, në të cilën seancë gjyqësore, përkatësisht në fillim të seancës, gjykata duke pasur parasysh se veprat penale ishin të natyrës së njëjtë për këto lëndë dhe për shkak të ekonomizimit dhe efikasitetit të procedurës, në kuptim të nenit 34, paragrafi 1 dhe 7 të KPPRK-së, me Aktvendim, bëri bashkimin e lëndëve penale P.nr.3/2023, P.nr.4/2023 dhe P.nr.6/2023, në mënyrë që në të ardhmen, për të njëjtat çështje penale të zhvillohet një procedurë penale dhe të vendoset me një aktgjykim, ndërsa numri i lëndës për këto lëndë do të mbetet ai më i vjetri, përkatësisht P.nr.3/2023. Pas leximit të aktkuzës, Prokurja e shtetit duke pasur parasysh faktin se për këto lëndë, objekti i veprave penale ishte i njëjtë, pala e dëmtuar e njëjtë, dashja e njëjtë e kryesit të veprave penale, kemi kontinuitet të vazhdueshëm kohor të kryerjes së këtyre veprave penale, e po ashtu duke e marrë parasysh edhe faktin se është dispozitë më e favorshme për të pandehurine, bëri rikualifikimin veprave penale nga vepra

penale, vjedhja e pyllit nga neni 349, paragrafi 1 të KPRK-së, në veprën penale, *në vazhdim* vjedhja e pyejeve nga neni 349 parag. 1, lidhur me nenin 77 të KPRK-së. Në të cilën seancë pas leximit të aktakuzave nga ana e prokurores së shtetit, i pandehuri P. M. deklaroi se e pranon fajësinë për kryerjen veprës penale, *në vazhdim* vjedhja e pyejeve nga neni 349 parag. 1, lidhur me nenin 77 të KPRK-së.

Prokurorja e shtetit Rozelida Manastiri, nuk e kundërshton pranimin e fajësisë, njëherit thekson se janë plotësuar kushtet për pranimin e fajësisë nga i pandehuri lidhur me këtë çështje penale.

Gjykata pas dëgjimit të palëve ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar pranimin e fajësisë, ngase ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë. Në këtë aspekt, gjykata ka konstatuar se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë; se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i akuzuari, se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza dhe aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Andaj, duke u bazuar në të cekurat më lartë, gjykata e ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

- se i akuzuari P. M., me dashje e ka kryer veprën penale: në vazhdim vjedhje e pyllit nga neni 349, paragrafi 1, e në lidhje me nenin 77 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitivin e këtij aktgjykimi, për të cilën veprën penale, gjykata të akuzuarin e shpalli fajtor, ngase veprimet e të njëjtit i përmbajnë të gjitha tiparet e kësaj vepre penale dhe se për të njëjtën është edhe penalisht përgjegjës.

Pasi që i akuzuari e ka pranuar fajësinë, gjykata nuk është lëshuar fare në administrimin e provave të propozuara si në aktakuzë, por drejtë është shkuar në fjalën përfundimtare të palëve.

Prokuroja e shtetit Rozelida Manastiri në fjalën përfundimtare deklaroi se në shqyrtimin e sotëm fillestar i pandehuri P. M., e pranoi fajësinë për veprat penale për të cilat i vihen në barrë, pranimin e fajësisë i njëjti e bëri vullnetarisht pa ndikim të dhunës, me pranimin e fajësisë u vërtetua gjendja faktike ashtu siç është përshkruar në dispozitivin e aktakuzës lëndore, me që u vërtetua gjendja faktike mbetet pranë aktakuzave dhe propozimeve të cilat të njëjtat i përmbajnë. Andaj kërkon nga gjykata që i akuzuari të shpallet fajtor dhe të njëjtin ta dënojë me dënim të paraparë me ligj, duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat si ato lehtësuese po ashtu edhe ato rënduese, në mënyrë që dënimi i shqiptuar të jetë në proporcion me shkallën e përgjegjësisë penale. Si rrethana lehtësuese gjykata të ketë parasysh gjendjen e

tij të vështirë ekonomike, premtimin që në të ardhmen nuk do të kryej veprë tjetër penale si dhe ndonjë rrethanë tjetër që gjen gjykata. Ndërsa si rrethana rënduese gjykata të ketë parasysh shakllën e përgjegjësisë penale, rrezikshmërinë shoqërore, qëllimin e kryerjes së kësaj veprë penale si dhe dëmin e shkaktuar të dëmtuares.

Përfaqësuesja e të dëmtuares A. M., në fjalën përfundimtare deklaron se, i bashkangjitet ndjekjes penale ndaj të akuzuarit dhe kërkon që gjykata që ta obligojë të akuzuarin tia kompenzojë dëmin e shkaktuar APK-së.

I akuzuari P. M. në fjalën përfundimtare deklaron se e pranon fajësinë, ka gabuar, është penduar, kërkon falje, është hera e parë që ka rënë ndesh me ligjin dhe i premtonte gjykatës se më nuk do të kryej këso vepra penale apo të tjera penale, kërkon nga gjykata që nëse eventualisht gjen prova dhe e shpall fajtor, të ketë parasysh gjendjen e tij të vështirë ekonomike në të cilën jeton, jeton vetëm me babin e tij, sepse nëna i ka vdekur para 8 viteve, në mënyrë që mundësisht ta liroj nga dënimi, apo t'i shqiptoj një dënim sa më të butë konform ligjit.

Me rastin e vendosjes për llojin dhe lartësinë e dënimit ndaj të akuzuarit për veprën penale të kryera, gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat të cilat në kuptim të neneve 69 dhe 70 të KPRK-së, ndikojnë në shqiptimin e drejtë dhe meritore të dënimit ligjor. Në veçanti për këtë rast si rrethana lehtësuese për të pandehurin gjykata pati parasysh faktin se i njëjti në fillim të shqyrtimit gjyqësor e ka pranuar fajësinë, gjendjen jo të mirë ekonomike të tij në të cilën jeton, se është penduar thellë për veprat penale të kryera, por këtë e bënë sepse nuk ka mundësi financiare që ti blejë drutë për nevoja të tija familjare, se për herë të parë ka rënë ndesh me ligjin dhe ndaj tijë nuk zhvillohet procedurë tjetër penale. Ndërsa gjykata nuk gjeti ndonjë rrethanë veçanërisht rënduese për të akuzuarin, andaj duke pasur parasysh shakllën e rrezikshmërisë shoqërore, peshën e veprës penale të kryer dhe mënyrën e kryerjes së sajë, i ka shqiptuar dënimin si në dispozitiv.

Sipas bindjes së gjykatës, dënimi me gjobë ndaj të akuzuarit P. M., duke i marrë për bazë rrethanat e përmendura më lartë, është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shakllën e përgjegjësisë të të pandehurit.

Gjykata, gjithashtu ka konstatuar se me këtë dënim, mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit nga neni 38 i KPRK-së, i cili konsiston në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij; të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

E dëmtuara Agjencioni pyjor në Novobërdë, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

Duke pasur parasysh natyrën e kësaj çështje penale dhe gjendjen financiare të pandehurit, gjykata, bazuar në nenin 449 paragrafi 2 nën paragrafi 2.6 të KPPRK-së, ka vendosur që të pandehurin ta detyrojë për ta paguar paushallin gjyqësor në shumën prej 20 € (Njëzetë euro), në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi me kanosje përmbarimi.

Pas shpalljes së aktgjykimit, në kuptim të nenit 367 të KPPRK-së palët janë udhëzuar për të drejtën në ankesë.

Nga të cekurat më lartë është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS NOVOBËRD
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM , DIVIZIONI PENAL**

2023:014297, 11.03.2024

G j y q t a r i

Sadri Krasniqi,d.v.

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve nga koha e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.